



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr.993/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Mentor Ismailit, Rinor Retkoceri, Valdet Buja, Alban Bajrami, Ali Stublla, Zenun Drnogllava, Ramiz Qeriqi, Mona Hasani, Nuriye Shala, Taibe Dula, Emin Krasniqi, Xhelal Lmani, Islam Osmani, Lumnije Bytyqi- Hasani, Bekim Neziri, Agon Bahtiri dhe Argjend Tasholli të gjithë kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.993/2021, paraqitur nga Mentor Ismailit, Rinor Retkoceri, Valdet Buja, Alban Bajrami, Ali Stublla, Zenun Drnogllava, Ramiz Qeriqi, Mona Hasani, Nuriye Shala, Taibe Dula, Emin Krasniqi, Xhelal Limani, Islam Osmani, Lumnije Bytyqi- Hasani, , Bekim Neziri, Agon Bahtiri dhe Argjend Tasholli të gjithë kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin kanë kërkuar rinumërimin e votave.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga Mentor Ismailit, Rinor Retkoceri, Valdet Buja, Alban Bajrami, Ali Stublla, Zenun Drnogllava, Ramiz Qeriqi, Mona Hasani, Nuriye Shala,

Taibe Dula, Emin Krasniqi, Xhelal Limani, Islam Osmani, Lumnije Bytyqi- Hasani, Bekim Neziri, Agon Bahtiri dhe Argjend Tasholli të gjithë kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me të cilën pretendojnë se gjatë numërimit të votave në Qendrat e Votimit QV 1301E, QV 1301X, 1302E, QV 1303E, QV 1304, QV 1305, QV 1306, QV 1307, QV 1308, QV 1310, QV 1312, QV 1313, QV 1317, QV 1321, QV 1322, QV 1323, QV 1324, QV 1325, QV 1326, QV 1327, QV 1328, QV 1330, QV 1331, QV 1332 ka pasur parregullësi, andaj përmes apelit kanë kërkuar që të bëhet rinumërimi në këto Qendra të Votimit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Mentor Ismailit, Rinor Retkoceri, Valdet Buja, Alban Bajrami, Ali Stublla, Zenun Drnogllava, Ramiz Qeriqi, Mona Hasani, Nuriye Shala, Taibe Dula, Emin Krasniqi, Xhelal Limani, Islam Osmani, Lumnije Bytyqi- Hasani, Bekim Neziri, Agon Bahtiri dhe Argjend Tasholli të gjithë kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me të cilën kanë kërkuar që të bëhet rinumërimi në Qendrat e Votimit QV 1301E, QV 1301X, 1302E, QV 1303E, QV 1304, QV 1305, QV 1306, QV 1307, QV 1308, QV 1310, QV 1312, QV 1313, QV 1317, QV 1321, QV 1322, QV 1323, QV 1324, QV 1325, QV 1326, QV 1327, QV 1328, QV 1330, QV 1331, QV 1332, në Komunën e Lipjanit është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesit e apelit në mbështetje të pretendimeve të tyre, nuk kane ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e tyre nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara andaj këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Keshtu qe Paneli vlerësoi se apeli nuk është i bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr.993/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesuese e Panelit**

**Kymete Kicaj**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.